



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI

PROJEKT RREGULLORE
PËR
NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E KOMUNËNS SË GJILANIT

Gjiçan, Shkurt 2023

Bazuar në nenin 12.2 pika c) e Ligjit për Vetë qeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), neni 38 pragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01 nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe me ndryshimet dhe plotësimet në Statut të komunës 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kuvendi i Komunës, në seancën e mbajtur më : 27.05.2021 miratoi:

RREGULLORE (KGJ) NR.3/2021
PËR
NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË GJILANIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurat të detajuara për menagjimin e ndarjes së bursave për studentët e Komunës së Gjilanit që studiojnë në Universitetet e Kosovës dhe në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit pa asnjë dallim mbi baza etnike, gjinore, racore, fetare apo politike si dhe kriteret e poentimit, kushtet e kërkuara, shpallja e konkursit, komisioni dhe deyrat e tij, komisioni i ankesave, ekzekutimi i pagesave etj.

Neni 2

Inicimi për Ndarjen e Bursave

1. Inicimin për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Gjilanit, me arsyetim e bënë Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për qdo vit akademik nëse është e mundur, duke i marrë për bazë mundësitë buxhetore që posedon Komuna.
2. Numrin e përfituesëve të bursave dhe lartësinë e të hollave për një përfitues, do të propozohet me shkrim nga Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa miratimin e bënë Kuvendi i Komunës si organi më i lartë i Komunës.
3. Bursat ndahen për studentët e Komunës së Gjilanit që studiojnë :
 - 3.1 Në Universitetet e Kosovës
 - 3.2 Në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.
4. Burast ndahen për periudhën 10 mujore;
5. Bursat ndahen për studentët e studimeve themelore.

Neni 3

Procedura në Kuvendin e Komunës dhe Komisioni

1. Pasi të arrihet kërkesa e arsyetuar me shkrim nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Kuvendi i Komunës e shqyrton dhe miraton apo jo.
2. Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë ndryshimin e numrit të përfituesve të bursave apo vlerën financiare për përfituesit, pas konsultimit dhe qëndrimeve financiare që do t’i jep Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Drejtoria e Arsimit formon komisionin në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.....
4. Mandati i anëtarëve të komisionit është ad hoc.....
5. Komisioni gjatë punës së tij është i obliguar të mbajë procesverbal me shkrim dhe i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit ka mospajtim apo nuk e nënshkruan procesverbalin, duhet të të jep deklarata me shkrim dhe i bashkëngjitet procevebalit.

Neni 4

Shpallja e Konkursit

1. Shpalljen e konkursit e bënë Drejtoria Komunale Arsimit , pasi që Kuvendi i Komunës ka miratuar kërkesën për ndarjen e bursave.
2. Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik.
3. Konkursi shpallet gjatë periudhës.....
4. Formularët e poentimit si dhe veprimet e tjera formale të procesit, i përgaditë komisioni në përputhje të plotë me këtë Rregulloreje.

Neni 5

Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për të fituar Bursën:

- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit;
- Shfrytëzues të bursave studentore, mund të jenë vetëm studentët e rregullt;
- Shfrytëzues të bursave studentore, mund të jenë vetëm studentët e rregullt me notë mesatare nga 7.0;
- Bursat do të ndahen vetëm për studentët që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve;
- Nuk mund të jenë përfitues të bursës më shumë se një studentë (aplikues) nga familja e ngushtë.

Kriteret e veçanta për të fituar bursën dhe poentomi :

- Studentët që studiojnë në Universitetet Publike1 pikë
- Nota mesatare -poentomi behet mbi bazën e notes mesatare.....
- Studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorëve dhe veteraneve të UÇK-së.....1 pikë
- Familjet që kanë tre (3) studentë e më tepër të rregullt1 pikë
- Studentët me gjendje të vështirë ekonomike.....1 pikë
- Studenti/ja i cili nuk i ka dy prindërit në jetë.....2 pikë
- Studenti/ja i cili nuk e ka njërin nga prindërit në jetë.....1 pikë

Neni 6

Dokumentet e Nevojshme për Aplikim:

1. Certifikata e notave (origjinale);
2. Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik , i/e rregullt;
5. Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë i dëshmorit/es;
6. Dëshmi se familja i ka 3 studentë në studime të rregullta;
7. Dëshmi për gjendjen e vështirë ekonomike (vërtetimi i asistencës sociale apo ndonjë dëshmi tjetër për gjendjen e vështirë ekonomike);
8. Dëshmi se studenti/ja nuk i ka dy prindërit apo njërin në jetë.
9. Dëshminë e xhirollogarisë bankare e konfirmuar nga banka përkatëse.

Neni 7

Shpallja e Rezultateve Preliminare

1. Pas përfundimit të punës së komisionit, shpallen rezultatet preliminare për përfituesit e bursave në afat prej tri (3) ditëve.
2. Shpallja bëhet publike në ueb faqën e Komunës së Gjilanit si dhe në tabelat e shpalljeve të Komunës.
3. Shpallja bëhet në formë të vendimit dhe nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit .

Neni 8

Ankesat dhe Komisioni i Ankesave

1. Kundër vendimit të publikuar me rezultate , studenti/ja, i/e pakënaqur, ka të drejtë të parashtojë ankesë, komisionit të ankesave në afat prej 8 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit.
2. Ankesa dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në kuadër të Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme.
3. Drejtoria Komunale e Arsimit, formon komisionin ad hoc për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të studentëve të pakënaqur.
4. Ankesat shqyrtohen dhe vendosen brenda periudhës prej 15 ditëve, nga dita e mbarimit të së drejtës për paraqitje të ankesës.
5. Drejtoria Komunale e Arsimit është e obliguar që menjëherë pas përfundimit të punës së komisionit të ankesave, jo më vonë se 3 ditë, t'i njoftojë paraqitësit e ankesave me përgjigje në ankesë si dhe ta bëjë shpalljen përfundimtare të rezultateve për përfituesit e bursave.
6. Në rastet kur komisioni i ankesave e aprovon ndonjë ankesë të studentit/es së pakënaqur duke ua njohur të drejtën e përfitimit të bursës komunale, atëherë, lista preliminare e shpallur me emra të përfituesvë mund të ndryshojë apo të zgjerohet, varësisht nga natyra dhe përmbajtja e ankesës.
7. Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtarë në procedure administrative.

Neni 9

Ekzekutimi i pagesave të përfituesëve të bursave

1. Nuk do të ekzekutohet asnjë pagesë e përfituesëve të bursave nga Komuna, derisa të shqyrtohen dhe vendosen ankesat e të pakënaqurve nga komisioni i ankesave.
2. Ekzekutimin e pagesave e bënë Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
3. Pagesat e përfituesëve të bursave bëhet në xhirrollogaritë bankare të përfituesit - studentit.
- 4.

Neni 10

Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores

Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Kuvendi i Komunës në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

Neni 11

Përgjegjësia dhe Zbatimi i kësaj Rregullore

1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore janë: Drejtoria Komunale Arsimit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
2. Mos zbatimi i kësaj rregulloreje, pasojnë masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi Komunal.

Kryesuesi i KK Gjilan

/Arianit Sadiku/